

PROJEKTI EURALIUS IV “KONSOLIDIMI I SISTEMIT TË DREJTËSISË NË SHQIPËRI”

Përshkrim i shkurtër i projektit

Projekti EURALIUS IV “Konsolidimi i Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri”, financuar nga BE-ja, filloi në shtator të vitit 2014 dhe do të vazhdojë deri në dhjetor të vitit 2017. Me pesë sferat e aktivitetit të tij, projekti do të mbështesë Ministrinë Shqiptare të Drejtësisë, Zyrën për Administrimin e Buxhetit Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Drejtësisë, Gjykatën e Lartë, Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, Gjykatat, Konferencën Gjyqësore Kombëtare, Komisionin Parlamentar të Ligjeve, Shkollën e Magjistraturës, Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe Dhomën Kombëtare të Noterisë, si përfituesit e tij kryesorë. Në përbërje të projektit janë dhjetë ekspertë me kohë të plotë nga Shtetet Anëtare të BE-së dhe nga Shqipëria, të vendosur me zyra në selitë e përfituesve kryesorë.

EURALIUS IV financohet nga Komisioni Europian me fondet IPA 2013 për Shqipërinë me një buxhet prej 4 milionë Euro.

Vizioni

EURALIUS IV është projektuar si një projekt i asistencës teknike të BE-së, që do të mbështesë dhe asistojë institucionet kryesore shqiptare të drejtësisë me qëllim përafrimin e performancës së tyre me standardet e BE-së. Objektivi kryesor i projektit EURALIUS IV është fuqizimi i pavarësisë, transparencës, eficiencës, përgjegjshmërisë dhe besimit publik në sistemin shqiptar të drejtësisë në pajtim me të drejtën dhe praktikat më të mira të BE-së.

Aktivitetet e Projektit

Produktet e punës të lidhura me pesë sferat e rezultateve të pritshme përfshijnë një përzierje të aktiviteteve që shtrihen nga këshillimi strategjik e deri tek fuqizimi institucional, mbështetje për hartimin ligjor, aktivitetet edukative, trajnuese dhe këshillimore, seminarët, workshopet dhe vizitat studimore në Shtetet Anëtare të BE-së.

Komponentët e projektit

1. Reforma në Drejtësi dhe Organizimi i Ministrisë

Qëllimi kryesor i këtij komponenti është ndihma për Ministrinë e Drejtësisë në zbatimin e një strategjie sistemi të drejtësisë me synim garantimin e pavarësisë, transparencës dhe eficiencës. Për më tepër, ai synon fuqizimin e profesionalizmit dhe përgjegjshmërisë së shërbimeve të Ministrisë së Drejtësisë dhe autoriteteve të varura. Po ashtu, ky komponent synon mbështetjen e aksesit të hapur për gjykatat për cilindo dhe transparencë të plotë të procedimeve gjyqësore.

2. Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Gjykata e Lartë

Aktivitetet e parashikuara sipas këtij komponenti synojnë mbështetjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë me qëllim sigurimin që vendimet në lidhje me statusin e gjyqtarëve të bazohen në kritere objektive dhe transparente në pajtim me standardet e BE-së. Mbështetja për Gjykatën e Lartë synon fuqizimin e pavarësisë dhe efektivitetit të saj duke siguruar që gjykata të përmbushë detyrën e saj kushtetuese për të shërbyer si orientuese e të gjitha gjykatave të tjera shqiptare duke unifikuar praktikën gjyqësore.

3. Drejtësia Penale dhe Zyra e Prokurorisë

Aktivitetet e parashikuara sipas këtij komponenti synojnë përshtatjen e kuadrit legjislativ në çështjet penale duke përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar, me standardet e BE-së dhe Këshillit të Europës. Për më tepër, aktivitetet synojnë përmirësimin e eficiencës së hetimeve penale, veçanërisht në lidhje me sferat e specializuara, si dhe fuqizimin e eficiencës dhe përgjegjshmërisë së shërbimit shqiptar të prokurorisë.


4. Administrimi dhe efienca gjyqësore

Fokusi në këtë komponent është tek transparenca e përmirësuar e vendimeve gjyqësore dhe efienca e shtuar e sistemit të drejtësisë. Komponenti do ta realizojë këtë duke përmirësuar bashkërendimin brenda sistemit të drejtësisë dhe duke përmirësuar menaxhimin e çështjeve, kodet procedural dhe përdorimin e teknologjisë në një nivel mbarë vendi. Komponenti synon lehtësimin e shkurtimit të kohëzgjatjes së gjykimit, uljen e çështjeve të mbartura në gjykata dhe dhënien e përmirësuar të shërbimit për përdoruesit e drejtësisë.

5. Profesionet ligjore dhe Shkolla e Magjistraturës

Synimi kryesor i aktiviteteve të parashikuara sipas këtij komponenti është fuqizimi i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Dhomës Kombëtare të Noterisë, Komisionit Shtetëror për Ndihmën Ligjore, veçanërisht duke dhënë mbështetje në lidhje me procedimet disiplinore, kodet e etikës dhe programet e trajnimit për avokatët dhe noterët, si dhe nëpërmjet mbështetjes për institucionet e shoqërisë civile që ofrojnë ndihmë ligjore. Përveç kësaj, ai synon asistencë për Shkollën e Magjistraturës duke zhvilluar më tej trajnimin e vazhduar për gjyqtarët dhe prokurorët.

STAFI I EURALIUS



Përshkrim i shkurtër i ekspertëve ndërkombëtar të EURALIUS

Dr. Rainer Deville, Shef Misioni

Dr. Rainer Deville, Gjyqtar pranë Gjykatës së Lartë të Apelit (Oberlandesgericht) në Gjermani, është Shefi i Misionit EURALIUS. Ai është emëruar gjyqtar në vitin 1989. Gjyqtari Dr. Deville ka gjykuar çështje penale, civile dhe tregtare në Gjykatën e Shkallës së Parë (Amtsgericht dhe Landgericht) dhe në Gjykatën e Lartë të Apelit (Oberlandesgericht). Ai ka një përvojë profesionale në çështje të administrimit dhe politikave në Ministrinë e Drejtësisë dhe Zyrën e Ekzekutivit të Landit të Vestfalisë së Veriut. Është anëtar i Zyrës Shtetërore të Provimeve në sistemin e drejtësisë (Landesjustizprüfungsamt), organi që merret me provimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të ardhshëm, si dhe të profesionistëve të tjerë ligjorë. Falë formimit të tij dhe përvojave të shumta ndërkombëtare në Bruksel dhe në shumë vende të tjera, Dr. Deville ka

menaxhuar me sukses disa projekte të BE-së në fushën e drejtësisë, duke kontribuar veçanërisht në aderimin e Letonise dhe të Kroacisë në Bashkimin Europian. Që prej shtatorit të vitit 2014 Dr. Deville drejton projektin EURALIUS duke u nisur nga vizioni se një reformë bindëse në drejtësi do të sjellë hapjen e negociatave të aderimit të Shqipërisë në BE.

Dr. Agnes Bernhard

Eksperte ndërkombëtare për Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe Gjykatën e Lartë.

Me një karrierë profesionale prej më shumë se 25 vjetësh Zj. Bernhard ka një përvojë shumë të gjerë në aktivitetet gjyqësore si anëtare e një gjykate administrative në nivel apeli në Austri, pranë Gjykatës Kushtetuese Austriake, si edhe në mbrojtjen e çështjeve të Austrisë në Gjykatën Europiane të Drejtësisë. Krahas kësaj, ajo ka ofruar vazhdimisht trajnime për gjyqtarët, prokurorët dhe nëpunësit civil, si dhe ka zbatuar një gamë të gjerë projektesh të asistencës teknike, ku ndër të tjera kanë qenë ato për Shkollën Shqiptare të Magjistraturës, Gjykatën e Kasacionit dhe të Drejtësisë në Rumani, si dhe Këshillat Gjyqësorë dhe të Prokurorisë në Kosovë. Ka kryer më shumë se 30 studime të ngarkuara nga Komisioni Evropian, veçanërisht, në fushën e aksesit në drejtësi, eficiencën e mjeteve ligjore, drejtësinë penale në fushën e mjedisit apo në drejtim të ligjit kundër diskriminimit. Zj. Bernhard mban titullin doktor në drejtësi dhe e ka nisur karrierën e saj pranë Universitetit të Linz-it në Austri dhe më pas në Institutin e të Drejtës Administrative dhe Kushtetuese.

Koraljka Bumci

Eksperte ndërkombëtare për Drejtësinë Penale dhe Prokurorinë

Znj. Koraljka Bumci është gjyqtare për Krimin e Organizuar (USKOK) pranë Gjykatës së Qarkut në Zagreb që prej viti 2007. Znj. Bumci ka qenë që prej vitit 1996 gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Zagrebit, ku ka gjykuar të gjitha llojet e çështjeve penale. Si gjyqtare për Krimin e Organizuar ajo është marrë me krimet e rënda të jakave të bardha (korrupsionin), trafikun e drogës, trafikun e qenieve njerëzore etj. Znj. Bumci është autore e shume artikujve të botuara në fushën e të Drejtës Penale e Proçeduriale. Ka qenë thellësisht e përfshirë si anëtare e Grupit të Punës për hartimin e Kodit të ri Penal në vitin 2011, si dhe ka kontribuar në hartimin e ndryshimeve të fundit të Kodit të Proçedurës Penale në vitin 2013. Gjatë karrierës së saj profesionale ajo ka ofruar trajnime për gjyqtarë dhe të stazhierë në të drejtën penale dhe atë të proçedurës penale. Ajo u emërua si pikë kontakti për Kroacinë për projektin PHARE 2005 “Mbështetja e Akademisë Gjyqësore të Kroacisë për zhvillimin e një sistemi trajnimi për gjyqtarët dhe prokurorët e ardhshëm” në kuadër të ndihmës gjatë proçesit të aderimit në BE.

Dr. Richard Regner

Dr. Richard Regner LL.M. ka studiuar në Universitetin e Vjenës dhe atë të Leicester, nga ku u diplomua në 1990 (Mag. Jur) dhe në 1997 (LL.M.). Z. Regner mban një gradë doktrate nga Universiteti i Vienës (Dr. Jur). pasi punoi si një kërkues shkencor si dhe asistent profesor ne Universiteti e Drejtësisë (1988-1990), ai u bë pjesë e Shërbimit të jashtëm Austriak, në vitin 1991, ku punoi kryesisht në fushën e së drejtës së Biznesit Ndërkombëtar dhe të drejtës Ndërkombëtare Publike. Në 1992 ai u emërua pranë Ambasadës Austriake në Hagë, ku dhe punoi si një asistent kërkimor për Universitetin European të Administratës Publike të Maastricht. Pasi punoi si një nëpunës shkencor ligjor pranë gjykatës Kushtetuese Austriake (1994-1995), ai filloi të punojë si partner dhe partner i huaj, pranë firmave private Juridike Gjermane (1996-1998). Pasi u kualifikua në provimin e avokatisë në Vienë në 1998, ai praktikoi avokatinë në Austri, dhe anëtarësua pranë shoqërisë avokatëve në Salzburg. Ai ka punuar me së shumti në Austri dhe Evropën Qëndrore si këshilltar pranë shoqërive privatë dhe shtetërore dhe duke menaxhuar firma juridike të përmasave të ndryshme. Fushat kryesore të punës, kanë qënë e drejta Kushtetuese, e drejta Administrative, ligji për shoqëritë tregtare, e drejta e korporatave, e drejta e prokurimit publik, ndihma juridike, dhe e drejtë ndërkombëtare biznesi. Ai është lektor i së drejtës Publike dhe Evropianë në Universitetin e shkencave të Aplikuara në Vienë që prej 2012 dhe ka disa publikime të fushave të ndryshme të interesit.

Miroslaw Giembicki

Z Miroslaw Giembicki ka studiuar pranë Universitetit Teknologjik të Varshavës në vitin 1993 dhe mban një titull Master në « Shkenca Kompiuterike dhe Inxhinierike ». Z Giembicki ka një eksperiencë profesionale 15 vjecare në menaxhimin e sistemit ICT në dizenjim, zbatim, prokurim, testim i standarteve ndërkombëtare - softeve dhe hardeve dhe shërbimeve. Për më shumë Z. Giembicki ka një eksperiencë disa vjeçare me analizimin, specifikimin, zhvillimin e sistemeve te IT për institucionet publikë, në vende si Kosova, Mali i Zi, Maqedonia, Serbia, Turqia e Shqipëria. Z Giembicki për një kohë të gjatë ka qënë ekspert IT për Delegacionin e Bashkimit European në Tiranë, lidhur më zbatimin e fondeve IPA për financimin e krijimit të një sistemi të menaxhimit të çështjeve për Prokurorinë Shqiptare. Gjatë punës së tij në Ballkan dhe më gjerë ai ka drejtuar një Projekt të financuar nga BE në Serbi, asistencë për Ministrinë e Drejtësisë Serbe lidhur me krijimin e një software për menaxhimin e çështjeve doganore (SENA).

LINK I FAQES ONLINE TE EURALIUS

Për më shumë informacion lutem klikoni faqen online të projektit: <http://www.euralius.eu/sq/>

